

	ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA
Njësia: Unit: Jednica:	Nr. Prot.: Prot. No.: <u>215/2018</u>
Jednica:	Br. Prot.:
Nr. i faqeve: No. of pages: <u>-03-</u>	Data: Date: <u>23.05.2018</u>
Br. stranica:	Datum: Datum:
Prihtimi/a	



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Prishtinë, 22.05.2018

## Kriteret e aplikuesëve në Komisionin për Edukim të Vazhdueshëm Mjekësor

- I. Shoqatat Profesionale të kenë dorëzuar planin e aktiviteteve për vitin rrjedhës, më së voni më 31 dhjetor të vitit paraprak
- II. Aplikuesit individual
  - 1. Profesionistët shëndetësor, anëtarë OMK, për përkrahje financiare të aktivitetit të tyre duhet të aplikojnë 2 (dy) muaj para ngjarjes në KEVM.
  - 2. Çdo përfitues duhet të ketë të konfirmuar mbështetjen financiare iniciale nga institucioni ku është i punësuar me së paku 30% e shumës së përcaktuar më poshtë.
  - 3. Çdo përfitues nga OMK obligohet që në afat prej 14 (katërmbdhjetë) ditë të sjell reportin e ngjarjes së aktivitetit bazuar në shtojcën 5 të U.A. 01/2016. Nëse nuk e kryen këtë obligim i njëjtë nuk ka të drejtë për aplikim në KEVM në 2 vitet e ardhshme për përkrahje financiare. Ky moment do të monitorohet me kujdes nga Zyrtari administrativ i ngarkuar në KEVM.
  - 4. Specializantët që konkurojnë duhet të kenë pëlqimin e mentorit klinik, kryetarit të komitetit, institucionit ku kryhet specializimi dhe Bordit të specializimit, si dhe të gjenden në listën e specializimeve me prioritet që cakton Ministria e Shëndetësisë, deri në bartjen e kompetencave tek OMK.
  - 5. Mbështetja financiare për prezantimet me gojë (vetëm autorë i parë) mbështetet si vijon:

- a. Shtetet e regjionit të Ballkanit deri në vlerën prej 600 €.
- b. Shtetet e BE deri në vlerën prej 800 €.
- c. Shtetet jashtë BE-së deri në vlerën prej 1.200 €.

III. Sponzorizimet e Kongreseve, Simpoziumeve dhe Seminareve vendore

- 1 Kongresi quhet i tillë vetëm nëse kanë si pjesëmarrës së paku 3 (tre) ligjërues jashtë Kosovës dhe së paku njëri prej tyre me titull të Profesorit Universtar.
- 2 Simpoziumet dhe Seminaret quhen të tillë vetëm nëse kanë sëpaku 2 (dy) ligjërues jashtë Kosove dhe së paku njëri prej tyre me titull të Profesorit Universitar.
- 3 Sponzorizimi bëhet deri në shumën prej 1.500 €.
- 4 Pjesmarrësit nga lëmia përkatëse të eventit ku OMK sponzorizon dhe akrediton, lirohen nga kuotizimi.

IV. Mbështetja financiare e botimeve të punimeve shkencore në revistat shkencore me impakt faktor:

- 1. OMK do të hap konkurs për financimin e punimeve shkencore cdo fillim viti;
- 2. OMK do të përzgjedh 5 punimet më të mira.
- 3. Shuma e mjeteve financiare dhe përzgjedha e punimeve do të përcaktohet në Konkurs publik të organizuar nga Këshilli Drejtues i OMK-së.

V. Anëtarët e OMK-së kanë të drejt vetëm një here në vitin kalendarik të përfitojnë mbëahtetje financiare.

VI. Akreditimi i aktiviteteve do të bëhet siq vijon më poshtë

- 1. Paraqitja e aktivitetit me kerkësë për akreditim duhet të bëhet së paku 30 ditë para datës së zhvillimit të aktivitetit;

2. Aktivitetet e Shoqatave Profesionale me kuotizime varësish nga niveli I aktivitetit – pagesa do të jetë prej 300€ deri në 500€ për procedura administrative
  - Kongreset – 500€
  - Simpoziumet dhe Seminaret me pjesëmarrje ndërkombëtare - 400€
  - Konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare - 300€.
3. Aktivitetete Shoqatave Profesionale pa kuotizime - Falas
4. Aktivitetet e organizuara nga Kompanitë prodhuese farmaceutike, kompanitë tregtare farmaceutike, dhe aparaturave mjeksore – pagesa prej 700 € për procedura administrative.

VII. Të gjitha vendimet financiare do të janë në varshmëri nga buxheti i OMK.

Kryetari i Komisionit të EVP-së

Prof. Ass. Dr Shemsedin Sadiku



Kryetari i OMK

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci.,